

## ANKESAT

### Ankesat nga studentët

Ankesat nga studentët mund të paraqiten online në faqen zyrtare të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në rubrikën “Ankesa”. Përmes kësaj rubrike në website, studentët mund të plotësojnë formularin përkatës dhe të paraqesin çdo shqetësim apo ankesë që lidhet me procesin akademik ose administrativ. Formulari gjendet në faqen zyrtare të universitetit dhe pasi plotësohet, ankesa dërgohet për shqyrtim nga strukturat përkatëse të universitetit. Link:

<https://unishk.edu.al/universiteti/ankesa-universiteti-i-shkodres-luigj-gurakuqi>

### Ankesat nga aplikantët për personel akademik/joakademik

Pas shpalljes së rezultateve të konkurseve, çdo kandidat ka të drejtë të deponojë ankesë pranë zyrës së protokollit të USH-së për vendimin e komisionit brenda 5 (pesë) ditëve punë nga shpallja e rezultatit. Rektori përcjell për rishqyrtim ankimin tek Komisioni ad-hoc, i cili, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së ankesës, shprehet me vendim.

Në përfundim të fazës së ankimit Rektori merr vendim për emërimin e kandidatit të shpallur fitues dhe ngarkon Drejtorinë Juridike (Sektori i Burimeve Njerëzore të USH-së) për hartimin e draft-kontratës për kandidatin e shpallur fitues.

### Ankesa apo kërkesa të përgjithshme

Çdo kërkesë/ankesë tjetër mund të paraqitet me shkrim pranë Zyrës së Protokollit ose mund të dërgohet nëpërmjet postës elektronike në adresën [info@unishk.edu.al](mailto:info@unishk.edu.al).

Kërkesat dhe ankesat përcillen për trajtim tek strukturat përkatëse, në përputhje me natyrën dhe përmbajtjen e tyre. Kthimi i përgjigjes bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së ankesës.